

20140441309

## LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

### Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13 dhe 170/13), në nenin 100 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, në stazh të sigurimit llogaritet koha që i siguruari deri në moshën 29 vjeçare e ka kaluar në marrëdhënie pune ose vetëpunësim me orar të plotë të punës, për të cilin është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në periudhë deri në 12 muaj në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.”

### Neni 2

Në nenin 118 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

“(4) Me përjashtim nga paragrafët (1) dhe (2) i siguruari deri në moshën 29 vjeçare i cili është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar me orar të plotë të punës dhe për të cilin është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në periudhë deri në 12 muaj në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, nuk është anëtar i detyrueshëm në shtyllën e dytë pensionale për atë periudhë.”

### Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” e do të zbatohet dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.